

No. 54850*

**Poland
and
Albania**

Agreement between the Government of the Republic of Poland and the Government of the Republic of Albania on the reciprocal promotion and protection of investments. Warsaw, 5 March 1993

Entry into force: *9 August 1993 by notification, in accordance with article 12*

Authentic texts: *Albanian, English and Polish*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Poland, 18 December 2017*

**No UNTS volume number has yet been determined for this record. The Text(s) reproduced below, if attached, are the authentic texts of the agreement /action attachment as submitted for registration and publication to the Secretariat. For ease of reference they were sequentially paginated. Translations, if attached, are not final and are provided for information only.*

**Pologne
et
Albanie**

Accord entre le Gouvernement de la République de Pologne et le Gouvernement de la République d'Albanie relatif à la promotion et à la protection réciproque des investissements. Varsovie, 5 mars 1993

Entrée en vigueur : *9 août 1993 par notification, conformément à l'article 12*

Textes authentiques : *albanais, anglais et polonais*

Enregistrement auprès du Secrétariat de l'Organisation des Nations Unies : *Pologne, 18 décembre 2017*

**Aucun numéro de volume n'a encore été attribué à ce dossier. Les textes disponibles qui sont reproduits ci-dessous sont les textes originaux de l'accord ou de l'action tels que soumis pour enregistrement. Par souci de clarté, leurs pages ont été numérotées. Les traductions qui accompagnent ces textes ne sont pas définitives et sont fournies uniquement à titre d'information.*

[ALBANIAN TEXT - TEXTE ALBANAIS]

MARRREVESHJE

NDERMJET REPUBLIKES SE POLONISE DHE REPUBLIKES SE SHQIPERISE
MBI NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TE INVESTIMEVE

Qeveria e Republikës së Polonisë dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë ,

Duke dëshiruar të intensifikojnë bashkëpunimin ekonomik me interes reciprok të të dy vendeve, me poshtë të quajtura Pale Kontraktuese,

Duke synuar të krijojnë dhe të ruajnë kushte të favorëshme për investimet nga investitorët e njërës Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese,

Duke patur parasysh nevojën për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve për stimulimin e zhvillimit ekonomik të Palëve Kontraktuese.

Ranë dakort si më poshtë:

Neni 1

P e r c a k t i m e

Per qellime te kesaj marraveshjeje:

1. Termi "investitor" për cilendo nga Palët Kontraktuese, përfshin:

a) persona fizike që kanë kombësinë e Palës Kontraktuese
b) persona juridike, përfshirë kompani, korporata, shoqëri biznesi dhe organizata të tjera, të cilat janë themeluar apo organizuar sipas ligjit të Palës Kontraktuese dhe kanë vendqendrimin e tyre si dhe aktivitetin ekonomik, në territorin e të njëjtes Pale Kontraktuese.

c) persona juridike të themeluar sipas ligjit të një vendi tjetër, të cilat direkt apo indirekt kontrollohen nga shtetas të asaj Palës Kontraktuese, ose nga persona juridike që kanë

vend-qendrimin si dhe aktivitetin e vertete ekonomik ne territorin e Pales Kontraktuese; kuptohet qe kontrolli kerkon zoterimin ne pronesi te nje pjese te konsiderueshme.

2. Termi "investim" nenkupton cdo lloje pasurie te investuar nga nje investitor i nje Pale Kontraktuese, me kusht qe ato te jene bere ne perputhje me rregullat dhe ligjet e Pales tjeter Kontraktuese, dhe perfshine ne vecanti ndonese jo ekskluzivisht:

a) pasuri e tundshme dhe e patundshme si dhe cdo lloj te drejte tjeter in rem si hipoteka, sigurimet e pasurise, te drejta legale, pengje etj.

b) aksione, pjese apo cdo lloj pjesmarrje tjeter ne kompani.

c) pretendime ne para apo ne ndonje forme tjeter qe ka vlere ekonomike.

d) te drejta autoresia, te drejta te pronesise industriale (si patenta, mostra perdorimi, projekte ose modele industriale, marka tregtare ose sherbimi, emra tregtare, sekrete te ndermarrjes) know-how dhe "good will".

e) te drejta te dhena nga nje autoritet publik per te kryer nje aktivitet ekonomik, perfshire koncensionet, per shembull, kerkimi nxjerrja apo shrytezimi i burimeve natyrore.

3. Qdo ndryshim ne formen e nje investimi, i bere ne perputhje me rregullat dhe ligjet e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles eshte bere investimi, le te pa prekur cilesine e tij si investim.

4. Ne qofte se investimi eshte bere nga nje investitor nepernjehet nje personi juridik qe nuk perfshihet nga paragrafi (c) i ketij Neni, ne te cilin ai ka pjesmarrje ne aksione, ky investitor do te gezoje perfitimet e kesaj Marreveshje ne perputhje me shkallen e pjesmarrjes se tij indirekte ne aksione, me kusht qe ky investitor nuk do ti gezonte perfitimet e kesaj Marreveshje po qe se investitori do te kerkonte zgjidhjen e mosmarreveshjeve sipas nje marreveshje tjeter per mbrojtjen e

investimeve te huaja, perfunduar nga Pala Kontraktuese ne territorin e se ciles eshte bere investimi.

5. Termi "te ardhura" nenkupton te gjitha shumat qe i perkasin nje investimi dhe ne vecanti, ndonese jo eksklusivisht, fitimet, interesat, te ardhurat nga kapitali, te ardhurat nga aksionet, shperblimet e te drejtes se autorit, shperblimet apo te ardhura te tjera.

6. Termi "territor" nenkupton respektivisht territorin e Republikes se Shqiperise apo territorin e Republikes se Polonise, si dhe zonat detare, perfshire fundin e detit dhe nentoken qe korrespondon me kufijte e jashtem te ujrave territoriale te seciles nga territoret e mesiperme, mbi te cilat Shtetet ne fjale ushtrojne, ne perputhje me ligjin nderkombetar, te drejttat e sovranitetit per eksplorimin dhe shfrytezimin e burimeve natyrore ne keto zona.

Neni 2

Nxitja dhe lejimi i investimeve

1. Secila Pale Kontraktuese do te nxise investimet ne territorin e saj nga investitoret e Pales tjeter Kontraktuese dhe do t'i lejoje keto investime ne perputhje me rregullat dhe ligjet e saj.

2. Kur nje Pale Kontraktuese ka pranuar nje investim ne territorin e saj, ajo duhet t'i jape ne perputhje me ligjet dhe rregullat e saj lejet e nevojshme ne nje investim te tille. Secila Pale Kontraktuese, kur eshte e nevojshme, merr persiper te jape autorizimet e nevojshme lidhur me aktivitetin e konsulenteve dhe personave te tjere te kualifikuar me shtetesi te huaj.

Neni 3

Mbrojtja dhe trajtimi i investimeve

1. Secila Pale Kontraktuese do te mbroje brenda territorit te saj investimet e bera nga investitoret e Pales tjeter

Kontraktuese, ne perputhje me ligjet dhe rregullat e saj, dhe nuk do te cenoje me masa te paarsyeshme apo diskriminuese, drejtimin, mire mbajtjen, perdorimin, gezimin, zgjerimin, shitjen dhe ne se ndodh, likuidimin e ketyre investimeve.

2. Secila Pale Kontraktuese do te siguroje trajtim te barabarte dhe te drejte ne territorin e saj, te investimeve te kryera nga investitoret e Pales tjeter Kontraktuese. Ky trajtim nuk do te jete me pak i favorshem se sa ai qe secila Pale Kontraktuese ju siguron investimeve te kryera ne territorin e saj nga investitoret e saj, ose ato qe secila Pale Kontraktuese u siguron investimeve te kryera ne territorin e saj, nga investitoret e kombit me te favorizuar, ne se ky trajtim eshte me i favorshem.

3. Trajtimi i kombit me te favorizuar nuk do te zbatohet per avantazhet qe nje Pale Kontraktuese u jep investitoreve te nje Shteti te trete per shkak te antaresise se tyre ne nje zone te lire tregtare, bashkim doganor, treg te perbashket apo organizate per ndihme reciproke ekonomike apo nga prania e nje konvente ekzistuese apo te ardheshme lidhur me shmangjen e baksimit te dyfishte apo per qeshtje te tjera fiskale.

Neni 4

Shpronosimi dhe kompensimi

1. Asnje nga Palet Kontraktuese nuk do te ndermarre, direkt apo indirekt, masa per shpronosimin, nacionalizimin apo masa te tjera me te njejten natyre apo me ndikim te njejte, ndaj investimeve qe i perkasin investitoreve te Pales tjeter Kontrak-

tuese, me perjashtim te masave qe ndermerren per interesa publike, ne baze jo diskriminuese dhe ne perputhje me ligjet e duke i siguruar nje kompensim efektiv dhe te pershtashem. Ky kompensim do te jete i barabarte me vleren e tregut te investimit te shpronësuar, ne momentin para shpronësimit ose per-